



FINANCIMI I BE-SË PËR ORGANIZATAT E GRAVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR: SFIDAT DHE MUNDËSITË

NGA NICOLE FARNSWORTH, RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS (RRGK)¹,
22.11.2017

HYRJE

Organizatrat e shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHCG-të) luajnë një rol vendimtar për përkrahjen, monitorimin dhe avokimin për zbatimin e reformave që kanë të bëjnë me proceset e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). BE-ja [e ka pranuar](#) rëndësinë që ka financimi i shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP). Megjithatë, [Udhëzuesi për përkrahjen e BE-së ndaj shoqërisë civile në vendet që duan të anëtarësohen](#) nuk merr parasysh çështjet gjinore. Në vitin 2015, Komisioni Evropian (KE) miratoi [‘Planin e Veprimit Gjinor’ \(PVGJ II\)](#) për

Tiparet kyçe të PVGJ-së II për IPA-n II

- Analiza gjinore duhet të krijojë të dhëna që duhet të përfshihen gjatë hartimit të të gjitha programeve
- Përfshirja e OSHCG-ve në hartimin e të gjitha programeve
- Përkrahja e OSHCG-ve
- Rritja e financimit për vajzat dhe gratë

Pse duhen financiar OSHCG-të dhe lëvizjet?

- **Rëndësia:** Sigurimi i informatave të tyre hyrëse gjatë procesit të hartimit të të gjitha programeve do të përmirësojë rëndësinë që kanë veprimet për grupet e synuara.
- **Efikasiteti:** Kosto më të ulëta, vend-ndodhje më e afërt, qasje më e mirë ndaj palëve të interesuara, njohuri për kontekstin dhe motivimi përmes përkushtimit ndaj ndryshimit social e jo ndaj fitimeve.
- **Efektiviteti:** Gjurmimi i ndryshimit social, rezultatet.
- **Qëndrueshmëria:** Pas përfundimit të veprimeve, OSHCG-të do të vazhdojnë të ekzistojnë dhe do të monitorojnë zbatimin, do të avokojnë për reforma. Investimet në ngritjen e kapaciteteve do të mbesin brenda vendit.

periudhën 2016-2020. Në të bëhet thirrje ‘që në të gjitha veprimet, çdo modalitet ndihme (p.sh. përkrahje nga buxheti)’ të integrohen të dhënat e nxjerra nga ‘analiza gjinore e konsoliduar dhe rigoroze që pasqyrohet në zbatimin përfundimtar të programit’; bëhet thirrje për konsultime me

OSHCG-të për të marrë të dhëna që do të shërbejnë për veprimet që ndërmerren në të gjithë sektorët; për përkrahje të pjesëmarrjes në politikë të OSHCG-ve; dhe për rritje të ‘financimeve të dedikuara në funksion të përmirësimit të rezultateve për gratë dhe vajzat’. [Këshilli i BE-së ka theksuar](#) ‘nevojën për rritjen e financimeve [...] për të garantuar zbatimin efektiv të [...] PVGJ-së’.

SFIDAT DHE MUNDËSITË E OSHCG-VE PËR TË PASUR QASJE NË FONDET E BE-SË

- Për shkak të [sistemeve jociësore të mbledhjes së të dhënave](#), mungojnë informatat lidhur me shkallën në të cilën financimet nga BE-ja kanë mbërritur te OSHCG-të. Kjo pengon monitorimin nëse financimi mbërrin tek OSHCG-të.
- [Financimi i agjencive të OKB-së](#) mbështetur në Programin e Përkrahjes së Shoqërisë Civile (CSF), – vënë në dukje vlerësuesit, – është ‘i pavend’.² Agjencitë e OKB-së duhej të merrnin 27.5% të [CSF-së në vitin 2016](#). CSF-ja duhet të financojë shoqërinë civile.
- [Grantet afatshkurtra](#) kontribuojnë në ndarjen e dobët² dhe ndërhyrjet josistematike, duke penguar kështu ndikimin. Ndryshimi i politikave dhe i shoqërisë kërkojnë kohë. Koha që kalohet duke mbledhur fonde/duke raportuar nuk shpenzohet për avokim.
- [Kufizimi i përdorimit të granteve operative](#), të cilat përbëjnë vetëm 9% të financimit në kuadrin e CSF-së së IPA-s II². OSHCG-të mundohen shumë për të siguruar burime njerëzore për të avokuar (d.m.th. të dhëna hyrëse për politikën, brenda një kohe të shkurtër pas njoftimit).

¹ RrGK është një rrjet i përbërë nga 126 OSHCG të ndryshme. Që prej vitit 2015, RrGK ka ofruar ekspertizë teknike për DBE-të në Kosovë, duke përfshirë edhe atë lidhur me PVGJ-në II. RrGK-ja jep këshilla lidhur me raportet e progresit dhe reformat kombëtare. Gjetjet mbështeten në përvojën e RrGK-së, shqyrtimi i dokumenteve ekzistuese dhe intervistat me 92 zyrtarë të BE-së, OSHCG-ve dhe zyrtarë të qeverisë në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, të realizuara në vitin 2017 me mbështetjen e fondacionit “Kvinna till Kvinna”.

² ‘Prezantimi i gjetjeve të vlerësimit të Programit për Përkrahjen e Shoqërisë Civile’, Prishtinë, 27.10.2017.

Përkrahja operative bën të mundur fleksibilitetin. Kjo është e rëndësishme edhe për ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve, një qëllim ky i BE-së.

- Shtrirja: IPA II ka komunikuar më mirë me grupet komunitare, por OSHC-të e vogla e të mesme vazhdojnë të kenë mbështetje të pamjaftueshme². Shumicës i mungojnë informacionet për financimin, shkathtësitë gjuhësore dhe burimet për të aplikuar.

DHËNIA PËRPARËSI SFIDAVE MJEDISORE NDAJ TË DREJTAVE TË GRAVE

- Qasjes 'si fillim të merremi me bazat' i mungon perspektiva gjinore. Zyrtarët e BE-së për BP-në besojnë (gabimisht) se çështjet "bazë" duhet të marrin 'prioritet ndaj' barazisë gjinore (e cila do të trajtohet 'më vonë'). Integrimi i pamjaftueshëm i çështjeve gjinore në të gjitha veprimet minon rëndësinë dhe efektivitetin.
- Llogaridhënia jociësore: Shumë delegacione të BE-së (DBE) nuk kanë raportuar lidhur me shumë indikatorë të PVGJ-së II. Në vlerësimin afatmesëm, PVGJ-ja II nuk u vlerësua. Treguesit e PVGJ-së II nuk janë përfshirë në raportimet e rregullta. Nëse DBE-të nuk janë të detyruara të raportojnë, atëherë nuk do të hiqen mënjatë burimet për arritjen e rezultateve.
- Integrimi i pamjaftueshëm i çështjeve gjinore: Pjesët ndërsektoriale të mostrave të IPA-s janë 'formalitet'. Çështjet gjinore duhet të bëhen patjetër pjesë e mostrave, duke përfshirë analizën gjinore në analizat e situatave, objektivat, rezultatet dhe treguesit. Përndryshe, për arritjen e synimeve rezervohen burime të pamjaftueshme. Zyrtarët e DBE-ve dhe përfituesit që hartojnë programet e IPA-s nuk kanë kapacitete në integrimin e çështjeve gjinore, gjë që kërkon ekspertizë dhe kohë. Disa DBE e kanë adresuar këtë duke kontraktuar ekspertë, p.sh. nga OSHCG-të (shih kutinë).
- Përfshirja e pamjaftueshme e OSHCG-ve: Sipas PVGJ-së II, 'angazhimi domethënës i palëve të interesuara' duhet të përfshijë patjetër edhe OSHCG-të. Ato nuk janë përfshirë sistematikisht në grupet sektoriale të punës, dialogët e politikave ose programim. Kjo minon efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë, meqenëse nevojat e grave nuk merren parasysh gjatë programimit dhe gratë përfshihen në mënyrë të pamjaftueshme në zbatim. Më tej, DBE-të nuk kanë marrë parasysh kostot e burimeve njerëzore që OSHCG-të të angazhohen në programimin e IPA-s, duke përfshirë kohën për shqyrtimin e dokumenteve, konsultimin me përfaqësuesit e zgjedhur, marrjen pjesë në takime, përgatitjen e të dhënave hyrëse dhe monitorimin e programimit.

Praktika më e mirë: Kontraktimi i ekspertëve të çështjeve gjinore

Në Kosovë, DBE-ja ka kontraktuar RrGK-në për të integruar perspektivën gjinore në dokumentet e planifikimit sektorial (DPS) dhe dokumentet e veprimit (DV) dhe për të siguruar një zyrë ndihme, duke ngritur kapacitetet e DBE-së, ministrive dhe MKBGJ-ve në integrimin e çështjeve gjinore dhe zbatimin e PVGJ-së II. Kjo ka përmirësuar integrimin e çështjeve gjinore në DPS dhe DV dhe kapacitetet në radhët e zyrtarëve. Kjo është një kontratë efikase dhe efektive shërbimesh me vlerë 70,000 euro për 30 muaj (procedurë e negociuar).

REKOMANDIME PËR DPFMNZ-NË

- Të përmirësohet menaxhimi i të dhënave duke përfshirë treguesit specifikë të OPSYS-it në: # e granteve që u jepen OSHCG-ve; shumën; fondet për barazinë gjinore; dhe tregues të tjerë të PVGJ-së II.
- Të ndryshohen mostrat (duke përfshirë DPS-të dhe DV-të) për të përfshirë si kërkesë edhe analizën gjinore, objektivat, rezultatet dhe indikatorët. Të kontraktohen ekspertë të barazisë gjinore për shqyrtimin dhe komentimin e të gjitha veprimeve përpara miratimit. Kjo është praktika më e mirë e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).
- Përmirësimi i llogaridhënies dhe raportimit për barazinë gjinore duke e bërë këtë të detyrueshme si pjesë e Raportit për menaxhimin e asistencës së jashtme, vlerësimeve të jashtme, shqyrtimeve dhe vlerësimeve.
- Të vihen DBE-të në dijeni se barazia gjinore është prioritet që është pjesë e agjendës "si fillim të merremi me bazat" dhe jo diçka e ndarë nga kjo agjendë.
- Në TeR-et dhe kontratat, t'u kërkohet kontraktorëve në të gjithë sektorët që të caktojnë fonde për integrimin e barazisë gjinore dhe për ekspertizën e çështjeve gjinore, duke kontribuar kështu në zbatimin e PVGJ-së II.

- Të nxitet kontraktimi i OSHCG-ve si ekspertë të çështjeve gjinore, duke njohur kështu ekspertizën e tyre. T'u mundësohet OSHCG-ve t'u kërkojnë llogari zyrtarëve me kalimin e kohës lidhur me realizimin e reformave në sektorë të veçantë, të ndërlidhura me çështjet gjinore. OSHCG-të gjithashtu mund të ofrojnë statistika tepër të rëndësishme, informacione cilësore dhe perspektivat e tyre.
- Të caktohen grante për veprim, për çuarjen më tej të barazisë gjinore: Ndonëse integrimi ka rëndësi thelbësore, të tillë rëndësie kanë edhe veprimet që ndërmerren në drejtim të barazisë gjinore, duke adresuar pabarazitë që vihen në dukje në analizat gjinore.
- Të nxitet rritja e shfrytëzimit të CSF-së së Granteve Operuese, në kuadrin e Marrëveshjeve Kornizë të Partneritetit (MKP) me OSHC të zgjedhura me konkurs, të cilat kanë reputacion, përbërje dhe strategji për t'u marrë me reformat afatgjate sociale dhe të politikave.³ Të caktohen fonde për OSHCG-të.
- Të vazhdohet dhënia e granteve përmes OSHC-ve lokale, sidomos Fondit të Grave, duke përfshirë grante më të mëdha e afatgjata: Të rriten shumat e disponueshme për nëndhënien e granteve (nënsubvencionimin) për 4+ vjet. Kjo do të lehtësonte barrën administrative të BE-së, do të përmirësonte efikasitetin, do të rriste mbërritjen apo komunikimin me OSHCG-të e mesme dhe do t'u mundësonte OSHCG-ve të mesme e të vogla që të kontribuojnë për ndryshime sociale afatgjata.
- Të përdoren modalitete të ndryshme financimi: Gërshetimi i granteve për veprim, granteve operuese të ndërlidhura me MKP-të, nëndhënies së granteve dhe i ekspertëve të kontraktuar të çështjeve gjinore mund të bëjë që mesazhi t'u komunikohet edhe OSHCG-ve të ndryshme.

Praktika më e mirë: Fondi i Grave të Kosovës

Fondi që administrohet nga RrGK, që u përmend nga DPFMNZ-ja si shembullor, u krijua përmes një procesi konsultimi me anëtarët e RrGK-së: OSHCG që merren me fusha të ndryshme. Ato përcaktojnë kriteret, duke u dhënë përparësi grupeve që jetojnë në vende rurale dhe që janë të cenueshme. Në qasjen inovative gërshetohet dhënia e granteve me zhvillimin e kapaciteteve përmes "nxënies përmes praktikës".

REKOMANDIME PËR PARLAMENTIN E BE-SË

- Të nxitet DPFMNZ-ja për të adresuar rekomandimet e sipërpërmendura.
- Të kërkohet nga KE-ja dhe DPFMNZ-ja të japin llogari në raporte lidhur me treguesit e PVGJ-së II. Të sigurohet që vlerësimet e pavarura të pasqyrojnë zbatimin e PVGJ-së II si pjesë të TeR-eve.
- Të përcillet raporti i PBE-së lidhur me fondet e BE-së për barazinë gjinore (2016/2144 (INI)), rekomandimet e datës 8 shkurt 2017, dhe të vazhdohet t'i bëhet presion KE-së për të përcjellë zbatimin e PVGJ-së II.

³ Në Vlerësimin e Jashtëm të IPA-s, ekspertët rekomandonin edhe qasjen afatgjatë (R1, fq. 44).